



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 651/2022

Datë: 23 maj 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr. 02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 17 maj 2022, KPK/Nr. 650/2022, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

- I. Për Transferimin e përhershëm të Prokurorëve të Shtetit si në vijim:
 - 1) Shtatë (7) pozita në departamentin e përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
 - 2) Një (1) pozitë në departamentin e përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.
- II. Prokurori i Shtetit mund të transferohet nga Departamenti i Prokurorisë Themelore në Departamentin e Prokurorisë tjetër Themelore të nivelit të njëjtë.
- III. Prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë kriteret për transferim të përhershëm në Prokuroritë Themelore në Prishtinë dhe Ferizaj, si në vijim:
 - Të jenë prokuror me mandat të përhershëm;
 - Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike dhe qortimit, përveç nëse transferimi është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës si masë disiplinore;
 - Të kenë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
- IV. Komisioni merr parasysh me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm, edhe përvojën e punës dhe vendbanimin e kandidatit.
- V. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë, nga e cila kërkohet transferimi.

- VI. Kandidati që aplikon për Transferim të përhershëm, duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
- Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 - Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 - Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.
- VII. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- VIII. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 23 maj 2022 deri më datë 06 qershor 2022.
- IX. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni në katin e katërt (4) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 406, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.